

**Projekti: “Të orientuar drejt suksesit
në karrierë. Identifikimi i nevojave
dhe mundësit për zhvillim.”**

Raporti Përfundimtar i Studimit

TABELA E PERMBAJTJES

1. HYRJE.....	3
2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË ANKETUARIT	4
3. INTERESAT DHE PLANET PËR TË ARDHMEN	4
4. KËSHILLIMIN NË KARRIERË	19
5. NJOHURITË PËR TREGUN E PUNËS	33
6. KONKLUZIONE.....	39

1. HYRJE

Analiza e paraqitur në këtë raport vjen si rezultat i një pune intensive të kryer në kuadër të projektit *“Të orientuar drejt suksesit. Identifikimi i nevojave dhe mundësitë për zhvillim”*, zbatuar nga organizata Be the Change, me mbështetjen financiare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është njohja dhe analiza e perceptimit të të rinjve për tregun e punës, si edhe nivelin e informacionit që të rinjtë kanë mbi këtë treg. Kështu, bazuar në të dhëna parësore të mbledhura nëpërmjet një anketa të posacme, ekipi ynë ka kryer edhe një analizë të rezultateve, mbi të cilat do të zhvillohet edhe një program përmirësimit e orientimi në karrierë.

Nevoja për të ndërmarrë këtë projekt lindi nga situata aktuale sa i takon punësimit të të rinjve, shifrave zyrtare por edhe perceptimit që vjen si nga vet të rinjë ashtu edhe nga punëdhënësit. Nëpërmjet këtij projekti, ne kemi synuar të:

- Masim dhe vlerësojmë nevojën për informacion që kanë nxënësit e klasave të 10-ta lidhur me orientimin në karrierë dhe tregun e punës
- Informojmë dhe forcojmë kapacitetet e të rinjve për t’u orientuar në karrierë
- Ndërgjegjësojmë dhe nxisim psikologët e shkollave dhe mësuesit për rëndësinë e këshillimit në karrierë me nxënësit

Kështu, për të matur situatën sa i takon nivelit të informacionit që të rinjtë kanë lidhur me tregun e punës por edhe për të kuptuar pak më tepër mbi planet e tyre të studimit, ekipi i projektit konceptoi një anketë të dedikuar. Anketa u organizua në disa seksione, duke ndjekur një rrjedhë logjike në përmbajtjen e pyetjeve për të siguruar mbledhjen e një informacioni gjithëpërfshirës.

- A1. Informacion i përgjithshëm për të intervistuarin
- A2. Seksioni i pyetjeve mbi interesat dhe planet për të ardhmen
- A3. Seksioni i pyetjeve mbi këshillimin në karrierë
- A4. Seksioni i pyetjeve mbi njohuritë për tregun e punës

Në këtë raport, ekipi paraqet në formë grafike dhe narrative rezultatet e analizës, bazuar në 1000 anketa të kryera.

2. 2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË ANKETUARIT

Ky seksion i anketimeve paraqet një pasqyë të përgjithshme mbi shpërndarjen e kampionit sipas faktorëve demografikë, duke përfshirë moshën, gjininë dhe urbanitetin.

Anketa e nxënësve u realizua me një kampion prej 1000 pyetësorësh, të cilat u shpërndanë në bashkite përkatëse, duke pasur parasysh faktorët e gjinisë, moshës dhe urbanitetit sipas kuotave të përcaktuara.

Kampioni u përzgjedh në mënyrë që të përfaqësojë nxënësit e klasave të 10-ta, me një ndarje të barabartë gjinore.

Në kampionin e pyetësorve, pjesa më e madhe e nxënësve, banojnë në qytet. Kjo ndarje e kampionit sipas urbanitetit siguron që të dhënat të jenë të ekuilibruara.




Figure A1-1 Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë

Sa i takon shpërndarjes së kampionit sipas moshës, grupmosha 15-16 vjeç përbën përqindjen më të madhe të nxënësve.

3. 3. INTERESAT DHE PLANET PËR TË ARDHMEN

Perceptimet e nxënësve mbi interesat dhe planet për të ardhmen u matën nëpërmjet një sërë pyetjesh të dedikuara, të përqëndruara më së shumti në planet që ata kanë pas përfundimit të arsimit të mesëm, fushat e studimit që ju interesojnë, burimet nga të cilat marrin informacionin, etj.

Pyetur lidhur me planet që ata kanë pas përfundimit të arsimit të mesëm, **shumica e nxënësve në Tiranë rreth (38%), Durrës (40%), Lezhë (48%), Vlorë dhe Shkodër (39%) kanë plane të qarta për të vazhduar studimet e tyre në arsimin e lartë.** Një përqindje e vogël e nxënësve nuk janë të sigurt për atë që do të

bëjnë pas përfundimit të arsimit të mesëm, ndërsa një grup në një mesatare për të gjitha bashkitë rreth 11% planifikojnë të emigrojnë për të gjetur mundësi të reja jashtë vendit dhe vetëm rreth (5%) do ndjekin një trajnim ose kurs profesional dhe (4%) do të kërkojnë punë. ***Të dhënat tregojnë se për shumicën e nxënësve, vazhdimi i studimeve të larta është prioriteti, ndërsa një pjesë e tyre gjithashtu shfaqin interes për të kombinuar vazhdimin e studimeve me përvojën në tregun e punës.***




Figure A2-1 Cfarë do të bëni mbasi të përfundoni arsimin e mesëm (gjimnazin)? (zgjidhni vetëm një alternativë)




Figure A2-1 Cfarë do të bëni mbasi të përfundoni arsimin e mesëm (gjimnazin) Durrës? (zgjidhni vetëm një alternativë)




Figure A2-1 Cfarë do të bëni mbasi të përfundoni arsimin e mesëm (gjimnazin) Lezhë ? (zgjidhni vetëm një alternativë)




Figure A2-1 Cfarë do të bëni mbasi të përfundoni arsimin e mesëm (gjimnazin) Shkodër? (zgjidhni vetëm një alternativë)




Figure A2-1 Cfarë do të bëni mbasi të përfundoni arsimin e mesëm (gjimnazin) Vlorë ? (zgjidhni vetëm një alternativë)

Më tej, nxënësit u pyetën lidhur me 3 fushat e studimit apo profesionet që ju interesojnë më shumë. Rezultatet për të gjitha bashkië tregojnë se **Mjekësia** paraqet fushën më të preferuar të studimit për nxënësit (39%), ndjekur nga **Financë/Menaxhim Biznesi** (30%) **Shkenca Kompjuterike** (27%) dhe **Arkitekturë** (24%), **Inxhinieri rreth** (20%), **Shkenca Shoqërore** (20%), **Drejtësi** (18%), **Art dhe Kulturë** (9%), **Sport** (9%), **Shkenca Natyrore** (8%). Të renditura si më pak të preferuara janë **Profesione të Lira** (8%), **Graphic Design** (5%), **Edukim dhe Studime Pedagogjike** (4%). Këto fusha tregojnë një interes më të ulët nga pjesa e nxënësve, por gjithsesi kanë një përfaqësim në listën e preferencave të tyre.




Figure A2-2 Cilat janë fushat tre fushat e studimit ose profesionet që ju interesojn më shumë për të gjitha bashkitë (pyetje e hapur)




Figure A2-2 Cilat janë fushat tre fushat e studimit ose profesionet që ju interesojn më shumë për secilën bashki (pyetje e hapur)

"Grafiku tregon qartë se **"Mjeksi"** është dega më e preferuar nga nxënësit në pesë bashkitë, ndërsa **"Shkencat e natyrës"**, **"Edukim dhe Studime Pedagogjike"**, kanë një nivel preferencë më të ulët."

Grafiku më poshtë, paraqet ndryshimet në preferencat e degëve, sipas gjinisë. Të dhënat tregojnë se ka pak diferencë gjinore sa i takon preferencës për degët e Shkencave Komputerike, Inxhinierisë apo Shkencave Natyrore. Ndërkohë, dukshëm degë si mjekësia, arkitektura apo arti dhe kultura, preferohen më tepër nga vajzat se sa djemtë. Nga ana tjetër, më tepër djem preferojnë degën e Sportit, se vajza.




Figure A2-2.1 Fushat e studimit ose profesionet që ju interesojnë më shumë vajzave dhe djemve.

Kur nxënësit u pyeten në lidhje me informacionin apo udhëzimin mbi këto zgjedhje, në Durrës rreth (75%), Lezhë (41%), Tiranë (57%), Vlorë (67%) e tyre u shprehën se kanë marrë mjaftueshëm informacion lidhur me zgjedhjet e tyre, ndësa ajo që u vu re ishte se në Shkodër rreth (36%) nuk kane informacion në lidhje me udhëzimet.




Figure A2-3 Keni marrë ndonjë informacion apo udhëzim mbi këto zgjedhje për të gjitha bashkitë?

Kur nxënësit u pyeten se nga cilat burime e kanë marrë informacionin në Durrës rreth (71%), Lezhë (73%), Shkodër (42%), Tiranë (61%) Vlorë (63%) e tyre u shprehën se e kanë marrë nga “Interneti”, me pas nga “Familjar” nga Shoqëria e me pas vijon nga Shkolla ndërsa nga Profesionistët vërehet një numër më i ulët. Kjo analizë ofron një pamje të qartë se si nxënësit mbështeten në burime të ndryshme për të marrë informacion në lidhje me zgjedhjet e tyre të ardhshme, ku interneti dhe familja janë burime kryesore.




Figure A2-4 Nëse po, nga cilat burime e keni marrë informacionin për secilën bashki?




Figure A2-4 Nëse po, nga cilat burime e keni marrë informacionin përfshirë të 5 bashkitë

Pyetur mbi elementët që nxënësit vlerësojnë më shumë kur mendojnë për profesionin, pasioni dhe interesat personale si edhe paga renditen si më kryesorët. Ndërkohë, këshillat e prindërve, dëshira për të ndihmuar shoqërinë dhe komunitetin apo udhëzimet e këshilltarëve të karrierës, renditen si më pak të vlerësuarat nga nxënësit kur mendojnë për të ardhmen e tyre profesionale.




Figure A2-5 Cfarë vlerësoni më shumë kur mendoni për profesionin/formimin tuaj të ardhshëm për të gjitha bashkitë? (zgjidhni 3 më të rëndësishmet)

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Pasioni dhe interesat personale	70%	59%	50%	66%	79%	65%
Mundësitë e punësimit të tregut të punës	30%	17%	42%	30%	21%	28%
Paga	90%	33%	65%	62%	63%	60%
Dëshira për të ndihmuar shoqërinë dhe komunitetin	35%	13%	12%	10%	8%	12%
Mundësitë për rritje në karrierë	55%	26%	58%	30%	42%	33%
Këshillat e prindërve	20%	7%	8%	13%	13%	12%
Këshillat e këshilltarëve të karrierës	5%	2%	0%	1%	8%	2%
Tjetër	0%	2%	0%	1%	0%	1%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	9%	0%	3%	0%	3%




Figure A2-5 Cfarë vlerësoni më shumë kur mendoni për profesionin/formimin tuaj të ardhshëm përfshirë të pesë bashkitë?

Pyetur nëse medojnë se janë mjaftueshëm të informuar për *fushat e studimit/profesionet që ju interesojnë dhe që kërkon tregu i punës*, rezultatet tregojnë se është shumë i rëndësishëm informacioni që ata duhet të kenë, i cili është në të njëjtën linjë në të gjitha bashkitë ndërkohë që pohojnë se nuk është i rëndësishëm

një numër i ulët i të anketuarve. Këto të dhëna vlen të diskutohen më tej për të kuptuar pak më mirë faktorët që ndikojnë në këtë vlerësim të informacionit dhe hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar situatën.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	45%	34%	27%	35%	38%	35%
Jo	20%	10%	38%	30%	25%	27%
Nuk e di	35%	49%	35%	31%	38%	34%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	7%	0%	4%	0%	4%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A2-6 A mendoni se jeni mjaftueshëm të informuar në lidhje me fushat e studimit/profesionet që ju interesojnë dhe që kërkon tregu i punës?

Pyetur lidhur me perceptimin e nxënësve, nëse gjinia e tyre ndikon në zgjedhjen e fushës së studimit, rezultatet tregojnë se një përqindje relativisht e vogël rreth 24% në nivelin e të gjitha bashkive e pjesëmarrësve mendojnë se gjinia e tyre ndikon në zgjedhjen e fushës së studimit, ndërsa një shumicë e madhe, prej (65%), nuk e perceptojnë një ndikim të tillë. Në anën tjetër, një përqindje e vogël, 8%, nuk janë të sigurt në lidhje me këtë çështje, ndërsa një përqindje shumë e vogël, 3%, nuk dëshirojnë të japin një përgjigje. Kjo analizë tregon se ndër nxënësit ka një shumicë të qartë që nuk e konsiderojnë gjininë si një faktor të rëndësishëm në zgjedhjen e fushës së studimit.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	20%	22%	11%	27%	17%	24%
Jo	70%	64%	71%	63%	71%	65%
Nuk e di	10%	8%	11%	7%	13%	8%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	5%	7%	2%	0%	3%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Analiza tregon se shumica e nxënësve në të gjitha bashkitë nuk besojnë se gjinia e tyre ndikon në zgjedhjen e fushës së studimit. Këto rezultate dëshmojnë se shumica e nxënësve konsiderojnë se zgjedhja e fushës së studimit nuk lidhet në mënyrë të konsiderueshme me gjininë e tyre.




Figure A2-7 A mendoni se gjinia juaj ndikon në zgjedhjen e fushës së studimit?




Figure A2-7 A mendoni se gjinia juaj ndikon në zgjedhjen e fushës së studimit përfshirë të pesë bashkitë?

Në kontekstin e pyetjes nëse prindërit dhe familjarët kanë ndikime në zgjedhjen e fushës së studimit u vërejt në nivel për të gjitha bashkië se një përqindje e vogël, rreth (9%), e pjesëmarrësve besojnë se prindërit dhe familjarët kanë një ndikim të madh në këtë zgjedhje, ndërsa një shumicë më e madhe, (53%) mendojnë se ata kanë një ndikim deri diku. Ndërkohë, një përqindje e konsiderueshme rreth (34%), besojnë se prindërit dhe familjarët nuk kanë asnjë ndikim në zgjedhjen e fushës së studimit.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po kanë shumë ndikim	5%	15%	14%	8%	0%	9%
Po deri diku	53%	41%	50%	56%	54%	53%
Jo nuk kanë fare	37%	36%	32%	33%	42%	34%
Tjetër	5%	2%	4%	1%	4%	1%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	7%	0%	2%	0%	2%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A2-8 Prindërit dhe familjarët kanë ndikime në zgjedhjen e fushës tuaj të studimit përfshirë pesë bashkitë?

4. 4. KËSHILLIMIN NË KARRIERË

Pyetjet në këtë seksion synojnë të mbledhin informacion mbi përvojën e nxënësve në lidhje me këshillimin e karrierës në shkollë. Rezultatet përfshirë të pesë bashkitë tregojnë se një përqindje e konsiderueshme, rreth (36%), e nxënësve shprehen se nuk kanë marrë këshillim karriere në shkollë, ndërkohë që rreth (29%) thonë se ndonjëherë kanë marrë këshillim karriere, rreth (19%) rrallë dhe rreth 13% shprehen se kanë marrë shpesh këshillim karriere në shkollë. Kjo analizë tregon se për shumicën e nxënësve, përvoja e këshillit të karrierës në shkollë është e kufizuar ose e munguar, ndërsa për një pjesë të vogël është një përvojë e zakonshme.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po shpesh	20%	14%	7%	12%	17%	13%
Ndonjëherë	45%	34%	39%	24%	46%	29%
Rrallë	15%	12%	29%	20%	8%	19%
Jo asnjëher	20%	27%	25%	40%	29%	36%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	14%	0%	3%	0%	4%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela me të dhënat nëse keni bërë këshillim karriere për secilën bashki.





Figure A3-1 Në shkollë, keni bërë këshillim karriere përfshirë pesë bashkitë?

Rezultatet për të gjitha bashkitë tregojnë se një përqindje e madhe, 48%, e nxënësve kanë thënë se këshillimi i karrierës është bërë “si një orë mësimi herë pas here”. Një përqindje e lartë, 40%, nuk preferojnë të japin një përgjigje” lidhur me këtë çështje, një përqindje më e vogël, rreth 9%, thonë se shkolla e tyre ka një zyrë për karrierë. Kjo analizë tregon se për shumicën e nxënësve, këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here, ndërsa për një pjesë të vogël ka një zyrë të specializuar për këtë qëllim në shkollën e tyre.


	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Shkolla jonë ka një zyrë karriere	0%	8%	4%	11%	0%	9%
Këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here	81%	29%	60%	46%	75%	48%
Tjetër	6%	2%	4%	3%	10%	4%
Nuk preferoj të përgjigjem	13%	62%	32%	40%	15%	40%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Durrës




- Shkolla jonë ka një zyrë karriere
- Këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here
- Tjetër
- Nuk preferoj të përgjigjem

Lezhë




- Shkolla jonë ka një zyrë karriere
- Këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here
- Tjetër
- Nuk preferoj të përgjigjem

Shkodër



- Shkolla jonë ka një zyrë karriere
- Këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here
- Tjetër
- Nuk preferoj të përgjigjem

Tiranë



- Shkolla jonë ka një zyrë karriere
- Këshillimi i karrierës bëhet si një orë mësimi herë pas here
- Tjetër
- Nuk preferoj të përgjigjem




Figure A3-2 Nëse po, si jeni këshilluar për zgjedhjen e karrierës apo hapat pas përfundimit të shkollës së mesme Durrës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë




Figure A3-2 Nëse po, si jeni këshilluar për zgjedhjen e karrierës apo hapat pas përfundimit të shkollës së mesme përfshirë të gjitha bashkitë?

Nxënësit u pyetën edhe mbi mënyrën se si ata do të donin të këshilloheshin për karrierën e tyre. Rezultatet për të gjitha bashkitë tregojnë se nxënësit preferojnë një kombinimin të këshillimit në grup dhe atij individual (rreth 32%). Rreth 9% e nxënësve duket se nuk janë të sigurt mbi metodën e preferuar.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Si do të don Këshillim individual	35%	19%	7%	24%	13%	22%
Këshillim në grup	10%	41%	50%	28%	38%	31%
Të dyja më sipër	50%	14%	36%	33%	46%	32%
Nuk e di	0%	19%	4%	10%	0%	9%
Tjetër	0%	0%	4%	0%	0%	0%
Nuk preferoj të përgjigjem	5%	8%	0%	6%	4%	6%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela me të dhënat se si do donin të funksiononte këshillimi i karrierës për secilën bashki.




Figure A3-3 Si do të donit të funksiononte këshillimi i karrierës përfshirë pesë bashkitë ? (mesatarja)

Nxënësit të cilët u bënë pjesë e anketës u pyetën edhe lidhur me burimet e informacionit që përdorin kur mendojnë për zgjedhjet që do të bëjnë sa i takon profesionit të tyre. Rezultatet për pesë bashkite tregojnë se dy burimet kryesore të informacionit janë familja dhe miqtë (57%) si edhe interneti (51%). Vetëm 33% e marrin informacionin nga shkolla dhe mësuesit, një përqindjen relativisht e ulët sidomos në pikëpamje të rolit kyç që shkolla synon të ketë në orientimin e karrierës.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Shkolla dhe mësuesit	70%	31%	43%	29%	52%	33%
Familja dhe miqtë	80%	52%	50%	57%	61%	57%
Interneti dhe burimet online	70%	28%	61%	53%	57%	51%
Tregu i punës dhe kompanitë	25%	17%	14%	27%	22%	24%
Organizatrat	5%	7%	0%	5%	9%	5%
Tjetër	5%	2%	0%	2%	0%	2%
Nuk preferoj të përgjigjem	5%	7%	0%	8%	4%	7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-4 Kur mendoni për zgjedhjet që do të bëni lidhur me profesionin që doni të ndiqni, nga e merrni informacionin kryesor përfshirë gjithë bashkitë (mund të zgjidhni disa alternative)?





Figure A3-4 Kur mendoni për zgjedhjet që do të bëni lidhur me profesionin që doni të ndiqni, nga e merrni informacionin kryesor për secilën bashki (mund të zgjidhni disa alternative)?

Nga ana tjetër, rreth 54% e nxënësve shprehen të kënaqur me këshillat që kanë marrë lidhur me zhvillimin në karrierë, rreth 36% neutral dhe 9% shprehen të pakënaqur.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po, shumë i/e kënaqur	47%	35%	32%	18%	39%	24%
Disi i/e kënaqur	16%	32%	21%	33%	17%	30%
Neutral	37%	32%	43%	36%	43%	36%
Disi i/e pakënaqur	0%	2%	4%	5%	0%	4%
Aspak i/e kënaqur	0%	0%	0%	8%	0%	5%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%



Pyetur lidhur me dakordësin e nxënësve se trajnimi i mësuesve dhe këshilltarëve të karrierës do të rrisë aftësinë e tyre për ti ndihmuar në zgjedhjet e tyre rezultojë se 36%, “janë plotësisht dakord” se trajnimi i mësuesve dhe këshilltarëve të karrierës do të rrisë aftësinë e tyre për të ndihmuar në zgjedhjet për t’u këshilluar më mire, rreth 52%, janë “mjaftueshëm dakord”. Një përqindje më e vogël, por e konsiderueshme prej 12%, janë kategorikisht kundër, duke thënë se trajnimi i mësuesve dhe këshilltarëve të karrierës nuk do të rrisë aftësinë e tyre për të ndihmuar dhe këshilluar më mirë. Të dhënat tregojnë se për shumicën e nxënësve, trajnimi i mësuesve dhe këshilltarëve të karrierës është i rëndësishme për përmirësimin e aftësive tyre për të ofruar ndihmë dhe këshillim karriere.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po, jam plotësisht dakord	47%	48%	25%	33%	54%	36%
Po, mjaftueshëm	53%	46%	61%	53%	33%	52%
Jo, aspak	0%	5%	14%	14%	13%	12%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-6 A mendoni se trajnimi i mësuesve dhe këshilltarëve të karrierës do të rrisë aftësinë e tyre për t'ju ndihmuar në zgjedhjet tuaja dhe për t'ju këshilluar më mirë?

Një rezultat interesant është përqindja e lartë e përgjigjeve të cilat thonë se shkolla e tyre ka një psikolog (92%), duke plotësuar një hallkë të parë të rëndësishme për rolin e tyre në këshillimin e karrierës.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	100%	88%	93%	93%	79%	92%
Jo	0%	3%	4%	2%	8%	3%
Nuk e di	0%	9%	4%	5%	13%	5%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-7 A keni një psikolog në shkollën tuaj?

Më shumë se gjysma e të anketuarve shprehen se e shohin psikologun si dike ku mund të kërkojnë ndihmë për pyetjet që mund të kenë për të ardhmen e tyre në karrierë.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	95%	66%	75%	57%	67%	61%
Jo	5%	34%	25%	43%	33%	39%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-8 Nëse po, e shikoni psikologun si dikë ku mund të kërkonti ndihmë lidhur me pyetjet/pavendosmëritë sa i takon zgjedhjes së karrierës tuaj?

Në shkollat e tyre, shumica e nxënësve kanë një psikolog, të cilin e shohin si një burim të rëndësishëm për informacion rreth këshillimit në karrierë. Megjithatë, përsëri, një përqindje e konsiderueshme, 73%, nuk kanë biseduar kurrë me ta lidhur me hapat që do të ndjekin për të përcaktuar dhe planifikuar karrierën e tyre. Kjo shpreh një mungesë të qartë në komunikim dhe përdorim të burimeve të disponueshme për mbështetjen e karrierës në mjedisin shkollës. Në këtë kontekst, ka nevojë për përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe përdorimit të shërbimeve të ofruara nga psikologët në shkollë për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin dhe realizimin e qëllimeve të tyre.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	50%	28%	25%	15%	27%	20%
Jo	40%	48%	71%	80%	73%	73%
Nuk e di	10%	24%	4%	5%	0%	7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-9 Nëse po, keni biseduar ndonjëherë me të lidhur me hapat që do të ndiqni pas gjimnazit?

Rreth 73%, e nxenesve e shohin përmirësimin e edukimit dhe orientimit në karrierë si shumë të rëndësishëm. Kjo tregon një besim të fortë në aftësinë e proceseve të edukimit dhe orientimit për të ndikuar pozitivisht në vendimet e të rinjve rreth zgjedhjes së fushës së studimit dhe punës.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	50%	28%	25%	15%	27%	20%
Jo	40%	48%	71%	80%	73%	73%
Nuk e di	10%	24%	4%	5%	0%	7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-10 A mendoni se përmirësimi i edukimit dhe orientimit në karrierë do të ndihmojë të rinjtë të marrin vendime më të mira rreth zgjedhjes së fushës së studimit dhe punës?

Rezultatet e anketës tregojnë se mbi 64% e nxënësve mendojnë se aplikacionet mobile ndikojnë pozitivisht në gjetjen e mundësive të punësimit. Një përqindje e vogël (3%) nuk janë dakord dhe rreth 29% janë deri diku dakord dhe 4% nuk kanë preferuar të përgjigjen. Duket se të rinjtë i vlerësojnë mjetet e teknologjisë së informacionet edhe sa i takon ndihmës që ato mund të japin në gjetjen e mundësive të punësimit.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po jam plotësisht dakord	15%	25%	14%	30%	38%	28%
Po mjaftueshëm	55%	39%	29%	37%	21%	36%
Deri diku dakord	25%	23%	54%	27%	38%	29%
Jo aspak	5%	2%	4%	4%	4%	3%
Nuk preferoj të përgjigjem	0%	12%	0%	3%	0%	4%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-11 Mendoni që aplikacionet mobile ndikojnë pozitivisht në gjetjen e mundësive të punësimit?

Në të gjitha bashkitë një pjesë e madhe e pjesëmarrësve konfirmojnë se ata nuk kanë përdorur platforma online apo aplikacione për të ndihmuar në zgjedhjen e fushës së studimit ose karrierës. Kjo tregon një nivel të ulët të përdorimit të teknologjisë për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në lidhje me zgjedhjen e karrierës.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	20%	34%	11%	25%	8%	24%
Jo	80%	66%	89%	75%	92%	76%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A3-12 A keni përdorur platforma online ose aplikacione që ndihmojnë në zgjedhjen e fushës së studimit/karrierës?

5. 5. NJOHURITË PËR TREGUN E PUNËS

Analiza në vijim do të synojë të shqyrtojë me hollësi të dhënat mbi njohuritë e tregut të punës dhe nevojat e tij.

Të anketuarit u pyetën cilat profesione/pozicione/aftësi mendojnë se ka më shumë nevojë tregu në këto momente. Rezultatet tregojnë se mjekësia renditet si fusha për të cilën ka më tepër nevojë tregu I punës (57%) pasuar mësuesi (30%) dhe me deget e programuesve/IT (23%) dhe Më pak të përzgjedhura si fusha për të cilat ka nevojë tregu janë inxhinieria, drejtësia, etj. Këto të dhëna mund të jenë më vlerë për të forcuar kapacitetet e udhëzuesve të karrierës. Kjo mund të shërbejë për të kryer edhe një analizë vijuese, për të kuptuar nëse perceptimi që kanë nxënësit përputhet me nevojat reale të tregut, bazuar në të dhënat më të fundit zyrtare apo analiza të tjera të ngjashme të kryera.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Mësuesi	41%	43%	42%	26%	35%	30%
Mjeksi	59%	52%	50%	55%	80%	57%
Drejtsi	18%	4%	33%	8%	5%	9%
Financë/Me naxhim Biznesi	12%	0%	17%	5%	5%	6%
Programues/IT	24%	17%	8%	28%	0%	23%
Inxhinier	47%	9%	8%	13%	25%	16%
Psikolog	6%	4%	25%	7%	5%	7%
Sportist	0%	4%	0%	2%	0%	2%
Arkitekt	6%	9%	0%	9%	15%	9%
Veteriner	0%	0%	0%	3%	0%	2%
Tjetër	0%	0%	8%	8%	0%	6%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A4-1 Për cilat profesione/pozicione/aftësi mendoni se ka më shumë nevojë tregu në këto momente?
(pyetje e hapur)

Analiza e pyetjes e cila fokusohet në perceptimin e nxënësve lidhur me lehtësinë e gjetjes së një pune kur ata të bëhen pjesë e tregut të punës. Rezultatet tregojnë se shumica prej tyre rreth 62%, shohin gjetjen e një punë si diçka që “nuk do të jetë shumë e lehtë”. Kjo tregon një nivel të konsiderueshëm të skeptisizmit ose vështirësive që mund të hasin ata në gjetjen e një pozicioni pune. Në anën tjetër, një përqindje më e vogël, por e rëndësishme rreth 19%, e shohin gjetjen e një punë si diçka të “lehtë”, ndërsa një përqindje më e vogël, 11%, e perceptojnë si “aspak e lehtë”. Vetëm një përqindje e vogël prej 7%, shohin gjetjen e një punë si “shumë e lehtë”. Kjo analizë tregon një shkallë të lartë të vetëdijëshmëris për nxënësit për sfidat që mund të përballen në tregun e punës, duke reflektuar një perceptim realist të situatës së punësimit.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Aspak e lehtë	16%	22%	11%	10%	4%	11%
Jo dhe aq e lehtë	63%	53%	64%	64%	58%	62%
E lehtë	16%	15%	18%	20%	29%	19%
Shumë e lehtë	5%	11%	7%	7%	8%	7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A4-2 Sa e lehtë mendoni që do të jetë për ju të gjeni një punë kur të bëheni pjese e tregut të punës?

Pyetur lidhur në perceptimin e nxënësve mbi favorizimin e diplomës universitare krahasuar me arsimin profesional në procesin e punësimit, shumica e tyre, 60%, shohin se një diplomë universiteti i favorizon më shumë në gjetjen e punës krahasuar me një arsim profesional. Kjo tregon një besim të përhapur në rëndësinë dhe vlerën e një diplome universitare në tregun e punës. Në anën tjetër, një përqindje më e vogël, por e rëndësishme, 17%, janë kundër kësaj ideje, duke e cilësuar se një arsim profesional mund të jetë po aq i vlefshëm sa një diplomë universitare. Këto të dhëna mund të shërbejnë edhe si një bazë mbi të cilën mund të vijojnë të ndërtohen fushatat ndërgjegjësuese sa i takon vlerës së një diplome profesionale dhe se si planet për të ardhmen mund të orinetojnë zgjedhjen më të përshtatshme.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po	58%	56%	54%	61%	63%	60%
Jo	16%	13%	23%	18%	4%	17%
Nuk e di	26%	31%	23%	21%	33%	23%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A4-3 Për t'u punësuar, mendoni që një diplomë universiteti ju favorizon më shumë se sa një arsim profesional?

Nxënësit u pyetën edhe lidhur me vlerësimin e tyre sa i takon rëndësisë së bashkëpunimit midis shkollës dhe kompanive private, në identifikimin e mundësive të punësimit për ta. Mbi 85% shprehen se ky bashkëpunim do të ndihmojë të rinjtë të zbulojnë mundësi punësimit dhe vetëm 8% nuk janë dakord.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Po jam plotësisht dakord	42%	39%	19%	45%	42%	42%
Po mjaftueshëm	53%	33%	74%	42%	38%	43%
Jo aspak	0%	11%	7%	7%	13%	8%
Nuk preferoj të përgjigjem	5%	17%	0%	6%	8%	7%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A4-4 A mendoni se bashkëpunimi midis shkollës dhe kompanive do të ndihmojë të rinjtë në zbulimin e mundësive të punësimit?

Në përmbyllje të anketës, nxënësit u pyetën lidhur me burimet nëpërmjet të cilave preferojnë të mësojnë më shumë rreth tregut të punës dhe karrierës. Rreth 49%, preferojnë seminare dhe ëorkshop-e në shkollë si një burim të rëndësishëm për të mësuar rreth këtyre çështjeve. Kjo tregon se pjesa më e madhe e tyre vlerësojnë mundësinë e të qenit të informuar nëpërmjet aktiviteteve të organizuara brenda shkollës. Një përqindje e konsiderueshme, 47%, preferojnë aplikacione dhe platforma online si një burim të rëndësishëm të informacionit. Kjo tregon pranimin e përhapur të teknologjisë dhe përdorimin e saj si mjet për të eksploruar dhe mësuar rreth tregut të punës dhe karrierës. Në anën tjetër, sesionet individuale me këshilltar karriere janë preferuar nga 38% e nxënësve, duke treguar vlerësimin e tyre për një ndërhyrje të personalizuar dhe të fokusuar në nevojat e tyre të individëve. Një përqindje e vogël, 4%, preferojnë burime të tjera për të mësuar rreth këtyre çështjeve, ndërsa 13% nuk preferojnë të japin përgjigje. Kjo analizë tregon një shumëllojshmeri të preferencave në mesin e nxënësve për burimet e tyre të preferuara për të mësuar më shumë rreth tregut të punës dhe karrierës.

	Durrës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Total
Seminare dhe workshop-e në shkollë	63%	30%	36%	53%	48%	49%
Aplikacione dhe platforma online	47%	39%	48%	48%	48%	47%
Sesione individuale me këshilltar karriere	53%	28%	44%	38%	39%	38%
Tjetër	0%	0%	4%	4%	9%	4%
Nuk preferoj të përgjigjem	5%	24%	4%	14%	9%	14%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%




Figure A4-5 Cilat burime preferoni më shumë për të mësuar rreth tregut të punës dhe karrierës (mund të zgjidhni disa alternative)?

6. 6. KONKLUSIONE

Kjo anketë është bazë e mirë informacioni, analiza e së cilës nxjerr në pah disa të dhëna të cilat, të kombinuara, mund të orientojnë më qartë masat që do të ndërmerren në vijm me qëllim një orientim më të mirë në karrierë.

Nxënësit shprehin një interes të madh për të marrë udhëzime dhe këshilla lidhur me zgjedhjen e profesionit dhe zhvillimin e karrierës së tyre. Shkolla dhe familja luajnë role të rëndësishme në sigurimin e këtij informacioni, ndërsa një përqindje e konsiderueshme e nxënësve shprehin dëshirën për

bashkëpunim mes shkollës dhe kompanive për të zbuluar mundësitë e punësimit. Ndër metodat e preferuara për të mësuar më shumë rreth tregut të punës dhe karrierës përfshijnë seminare dhe ëorkshop-e në shkollë, aplikacione dhe platforma online, si dhe sesione individuale me këshilltar karriere. Kjo tregon nevojën për një përjasje të përshtatshme për të ofruar udhëzim dhe informacion lidhur me karrierën për të rinjtë. Këto rezultate tregojnë rëndësinë e një bashkëpunimi të ngushtë midis arsimit dhe sektorit të punës për të siguruar një përgatitje të suksesshme dhe të përshtatshme për tregun e punës për të rinjtë.



Ky Raport u realizua me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, (AKR) dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, (MSHRF). Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e AKR-së dhe MSHRF-së.